



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:100994

Datë: 14.10.2020

Numri i dokumentit: 01203481

PKR.nr.101/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët Mentor Bajraktari – kryetar i trupit gjykues, Besarta Doli dhe Drilon Haraçia – anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale ndaj të akuzuarit H. Sh. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga 267 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër PP/I.nr.44/2019, të datës 28.05.2019, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 06.07.2020, 21.07.2020, 30.07.2020, 27.08.2020, 11.09.2020, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ali Uka, të akuzuarit si dhe mbrojtësit të tij avokatit H. M. nga Prishtina, **me datë 16.09.2020** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 14.10.2020 e përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

H. SH., nga i ati S., e ëma S., e gjinisë S., data e lindjes . . . në . . . , ku edhe tani banon në rrugën “. . . ” nr. . . , i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion vozitës, i gjendjes së mesme, ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: . . .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse pa autorizim ka posedua me qëllim shitje substancën narkotike e cila me ligj është shpallur si narkotik, në atë mënyrë që ditën kritike me datën 07.05.2019, rreth orës 14:10 minuta, DHTN në Gjakovë, duke vepruar në bazë të një urdhri verbal të Prokurorit të shtetit, e të konfirmuar nga ana e Gjykatës, nën numrin PN.Kr.nr.9/19 të datës 08.05.2020, ka bërë kontrollin e shtëpisë e objekteve tjera përcjellëse të të akuzuarit H. Sh., në rrugën “. . . ” nr. . . , ashtu që në garazhin e shtëpisë së të akuzuarit prapa disa makinave të pompës së derivateve të fSh.ra janë gjetur tre (3) paketime të mëdha me ngjyrë të zezë të mbushura me substancë narkotike e të cilat nga raporti i ekspertimit me numër AKF/2019-1268/2019-1131, i përpiluar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me datën 09.10.2019, ka rezultuar të jetë e llojit “Marihuanë” në peshë neto të përgjithshme prej 63200 ± 0.0025 gram.

Me këto veprime ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 79 dhe nenit 267 par.1 dhe par.5 të KPRK-së, si dhe nenit 282 par.1 dhe 2 nënpar.1.4 si dhe 365 të KPP-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej pesë (5) vite e gjashtë (6) muaj, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 07.05.2019 gjerë në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi dhe **ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej dymijë (2000) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej një (1) muaji, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë të akuzuarit dënimin me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind (100) ditëve, duke ia llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga njëzet (20) Euro.

Ndaj të akuzuarit **KONFISKOHET**, substanca narkotike e llojit “Marihuanë” në peshë neto të përgjithshme prej 63200 ± 0.0025 gram, si objekt i veprës penale.

Urdhërohet Stacioni Policor në Gjakovë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e sasisë së lartpërmendur të substancës narkotike të konfiskuar, që në polici evidentohen sipas numrit të rastit 2019-DHTN-315.

Detyrohet i akuzuari që ti paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej treqind (300) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjakovë - Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate me datën 29.05.2020, ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.44/2019, të datës 28.05.2019, ndaj të akuzuarit H. Sh. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga 267 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari H. Sh., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë.

Prokurori i shtetit Ali Uka, në fjalën e tij përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik ndaj të akuzuarit H. Sh., duke theksuar se gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale pas administrimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve u vërtetua gjendja faktike sikurse në aktakuzë. Nuk qëndron mbrojtja e të akuzuarit H. Sh. meqenëse nga provat e administruara të këtij shqyrtimi gjyqësor pos tjerash edhe nga dëshmia e dëshmitarit E. H. e dhënë si në Polici, tek prokurori i

çështjes dhe në këtë shqyrtim gjyqësor i cili pos tjerash ka deklaruar se kamionin me cisternë në tabelat e regjistrimit . . . ka qenë pronë e të akuzuarit H. Sh. dhe asnjëherë nuk e ka vërejtur që me këtë kamion të ketë vozitur dikush tjetër përveç H.. Po ashtu edhe nga dëshmia e dëshmitarit F. L. e dhënë në polici i cili pos tjerash ka deklaruar se në garazhin ku janë gjetur substancat narkotike e njëjta është shfrytëzuar nga H. Sh., i cili vazhdimisht ka parkuar kamionin e tij me cisternë, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit M. B. i cili ka deklaruar se nga muaji qershor i vitit 2018 punon në pompën e benzinës dhe sipas tij kamioni me cisternë është pronë e të akuzuarit H. Sh. i cili vazhdimisht e ka vozitur atë kamion dhe se dy ditë para rastit kritik i akuzuari H. ka shkuar tek ai në pompën e benzinës për ti kërkuar shampon për pastrimin e duarve meqenëse kishte bërë ndërrimin e gomës së kamionit të tij të dëmtuar dhe se kamioni gjithëherë ka qenë në shfrytëzim të akuzuarit H. i cili vazhdimisht ka parkuar kamionin në garazhin ku është gjetur substanca narkotike. Po ashtu edhe dëshmitari H. Z. për të cilin i akuzuari H. ka deklaruar se ditën kritike e ka dërguar në Prishtinë me automjetin e tij VW “Golf 4”, e në të cilën e ka harruar telefonin e tij e siç deklaroi H. nuk është e vërtetë që H. i e ka harruar telefonin dhe jaknen në automjetin e tij. Po ashtu dëshmitari G. Sh. ndryshe vëllai i të akuzuarit H. në polici posh tjerash ka deklaruar se garazhi i cili gjendet në anën e djathtë është shfrytëzuar për parkingun e kamionëve ndërsa garazhi tjetër në anën tjetër të anës së majtë ku ka qenë e fSh.r substanca narkotike është shfrytëzuar nga vëllai i tij H. Sh.. Po ashtu edhe takimi me të akuzuarit me një person të pa identifikuar na dërgon deri tek përfundimi se i akuzuari është marr me shitblerjen e substancave narkotike. Nuk qëndron po ashtu mbrojtja e të akuzuarit e dhënë në polici, e po ashtu edhe tek prokurori i çështjes dhe në këtë shqyrtim gjyqësor se tri paketimet e najlonit ngjyrë e zezë e cila ka dalë të jetë “marihuanë”, që janë gjetur gjatë bastisjes nga ana e policisë se nuk janë të tijat dhe se nuk e di kush ka mundur ti lë aty dhe as të kujt janë ato paketime meqenëse sipas tij ato garazhe i ka shfrytëzuar edhe “. . .” si dhe personat tjerë meqenëse nga dëshmitë e dëshmitarë në procedurë provohet e kundërta se një mbrojtje e tillë e dhënë nga ana e të akuzuarit është plotësisht e pa bazë dhe në drejtim të ikjes nga përgjegjësia penale. Prandaj nga të gjitha provat si ato materiale dhe ashtu formale që janë cekë në fjalën përfundimtare e të administruara në këtë shqyrtim gjyqësorë në tërësi u arrit që të provohet se i akuzuari H. Sh. ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së. Ashtu që gjykatës i ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtorë për veprën penale për të cilën ngarkohet me aktakuzë, të gjykohet sipas ligjit dhe njëkohësisht ndaj tij të konfiskohet substanca narkotike si në dispozitiv konform nenit 267 par.5 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit H. Sh. av.H. M. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: Aktakuza me numër dhe datë mbi bazën e të cilës gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësor, provat të cilat prokuroria i ofroi gjykatës, mbrojtja konsideron se nuk është arritur niveli i standardit përtej dyshimit të bazuar mirë në parimin e probabilitetit provues, kualitetit të provave që vërtetojnë faktet vendimtare që i mbrojturi imë të ketë kryer veprën penale. Duke e analizuar provat administruara në gjykatë dhe të elaburuara me fjalën përmbyllëse nga prokurori mbrojtja i propozon gjykatës që gjatë vlerësimit të vije në konkludimin se të gjitha këto prova qoftë materiale apo verbale nuk argumentojnë identitet objektiv dhe subjektiv të akuzës për këto shkaqe, çështja kryesore mbi faktin se ku u gjend narkotiku në sasi dhe lloje sipas ekspertizës në të cilën thirret prokuroria lindë pyetja a ishte në kamionin “Man” ngjyrë të gjelbër, a ishte në kamionin “Cisternë” që në rrethanën e dëshmimeve që i prezantuan gjykatës lidhur me faktin se kush ishte vozitësi i këtyre kamionëve kur prova kryesore është vendi i ngjarjes, raporti mbi bastisje në garazhin ku kanë qasje jo vetëm punëtorët e “. . .” ku kanë të vendosur agregatin (gjeneratorin) e rrymës dhe faktin se fotoja nga procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit av.L. u vërtetua se kamioni i “. . .” ishte në atë garazhe ku është gjetur narkotiku e cila garazhe nuk dyer në hyrje dhe ndaj asaj garazhe nuk ka asnjë provë qoftë edhe raport siç kërkon prokurori i shtetit

ti cilësoi si prova se është bërë një ekzaminim i gjurmëve të gishtërinjve (në qese të najlonit apo në ambientin në afërsi të këtij narkotiku) edhe nuk është bërë asnjë ekzaminim i ADN-së, që me saktësi dhe në kuptimin shkencorë të vërtetohet se kujt i përket ky narkotik, kjo nuk ka ndodhur ? Dëshmitë e dëshmitarëve që u elaboruan nga prokurori i shtetit në aspektin juridik paraqesin tregimet e tyre në raport me H. Sh.n, që cilësohen si deklaratime rrethore por jo provë apo vërtetim të ndonjë fakti që mbështetë dispozitivin e akuzës (identitetin objektiv dhe subjektiv) apo ndonjë fakt relevant lidhur me figurën e veprës apo ndonjë veprim inkriminues të të akuzuarit në raport me veprën penale. Identiteti objektiv i përshkruar në aktakuzë përmban datën (kohën) përmban vendin dhe mënyrën që më tepër mbrojtja nuk do ta analizoi sepse një dispozitiv i tillë nuk përkon me të vërtetën materiale por më tepër merret me një datë që përputhet me ditën e arrestimit të mbrojturit tim merret me një lëndë që ka qenë e regjistruar në prokurori (në regjistrin e personave të panjohur me numër PN.KR.nr.9/19 të datës 08.05.2019), mbi bazën e këtij numri është bërë bastisja dhe kontrolli i shtëpisë ku jeton i akuzuari por prokuroria e shtetit nuk i ofroi gjykatës asnjë provë të vetme lidhur me rezultatin qoftë të bastisjes së automjeti kur është bërë dita e arrestimit të akuzuarit e që gjykata ka njohuri se rezultatet janë negative, rezultatet janë negative edhe në bastisjen dhe kontrollin e shtëpisë së H. Sh.t, për më tepër që mbrojtja e lutë gjykatën për vëmendje nga vetë raporti i dorëzuar në gjykatë nga policia- hetuesit e antidrogës në plotësimin e provave nga raporti i datës 23.06.2020, ku njoftohet gjykata se “nxjerrja e video-incizimeve nga kompania “. . .” pasi kemi marr të regjistruar me USB nga zyra përgjegjëse e IT, aty nuk kanë qenë datat 03, 04, 05, dhe 06.05.2019, por vetëm datat 31.04.2019 dhe 01.05.2019, 02.05.2019, dhe një kohë e datës 06.05.2019... ?!, anomalia qëndron në faktin se me datën 06.05.2019, thuhet një kohë nga kjo datë, prova të tilla të selektuara të mos të themi të fabrikuar prova selektive apo parciale për datat e caktuara jo vetëm që e vë dyshimin në pranushmerinë e provës apo besueshmërinë por e vënë në pyetje jo vetëm këto dy institute kredibilitetin e akuzës, bazën juridike, parimet thelbësore të drejtësisë e që janë në kundërshtim të plotë me Kodin e Procedurës dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës për një gjykim të drejtë, të ligjshëm, sigurinë juridike të qytetarëve dhe parimeve tjera në bazë të efikasitetit. Parimi i lashtë nga sentenca latine më ofro prova të jap aktgjykimin-drejtësinë është në kundërshtim të plotë kjo aktakuzë dhe pozicioni i prokurorit është i pa bazuar në vërtetim të gjendjes së fakteve. Gjithashtu parimi i prezumimit të pafajësisë që sanksionohet me nenin 7 dhe 48 të KPP-së, e që vije në kundërshtim prokuroria me nivelin e detyrës për ta argumentuar fajësinë apo pafajësinë e të mbrojturit tim por anbllok vetëm në aspektin teorik përkon fajësinë dhe të shpallet fajtor duke u dënuar i mbrojturi imë për veprën që e ngarkon pa bazë. Mbi këto fakte të gjithë dëshmitarët e familjes Sh. potencialisht mund të kenë qenë të dyshuar dhe asgjë nuk e ka penguar prokurorin që edhe ata të i akuzoi për këtë veprë penale, çdo person që ka punua në “. . .” që narkotiku është gjetur 10 deri 15 metra nga vendi i punës së tyre në garazhin pa dyer dhe dritare dhe asnjë sqarim prokuroria nuk jep se pse këta persona nuk janë të dyshuar potencial? Është çuditshëm fakti se si është vepruar në raport me H. Sh.n nën supozimin se “kinse i vetmi person që mund të jetë i dyshuar është H. Sh.”. Nëse nuk aplikohet neni 364 par.1 pika 1.3 të KPP-së se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet i vetmi parim që mund të aplikohet është parimi In-Dubio Pro Reo në favor të akuzuarit, e jo të aplikohet parimi In-Dubio-Kontrareo në dëm të tij.

I akuzuari H. Sh. në fjalën përfundimtare të tij ka deklaruar se në tërësi pajtohem me fjalën përfundimtare të mbrojtësit av.H. M. dhe nuk kam çka të shtoj tjetër.

2. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova materiale: ka dëgjuar dëshmitarët: M. B., M. Sh., E. H., B. T., H. Z. dhe F. L. si dhe ka

administruar provat materiale dhe atë: raportin e oficerit Sh. S. me numër të rastit 2019-DHTN-315 të datës 07.05.2019, dëftesën për konfiskimin e pronës me numër të rastit 2019-DHTN-315 të datës 07.05.2019, procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave të datës 07.05.2019, raportin plotësues të oficerit Sh. S. me numër të rastit 2019-DHTN-315 të datës 25.07.2019, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me numër të rastit 2019-DHTN-315 të datës 07.05.2019, raporti mbi ekzaminimin e substancës narkotike të përpiluar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë në Prishtinë me numër AKF/2019-2168-2019-1131 të datës 09.10.2019, shikimin e CD-së nga video incizimet e vendit të ngjarjes dhe CD-së nga hartografia, raportin e oficerit A. B. të datës 02.09.2019 me numër të rastit 2019-DHTN-315, së bashku me fotoalbumin me të njëjtin numër dhe me të njëjtën datë, raportin mbi nxjerrjen e gjurmimeve të vijave papilare të ekspertimit të Agjencisë të Kosovës për Forenzikë me numër AKF-201-1268-2019-1128 i datës 21.06.2019, raporti plotësues të oficerit Sh. S. të datës 23.06.2020, së bashku me CD-në, padia e dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, me numër të lëndës C.nr.225/2013, padia për vërtetimin e pronës dhe anulimin e kontratës e datës 17.06.2019 e dorëzuar Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, kundërpadia me numër C.nr.209/17 e datës 23.10.2019 e dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, përgjigja në padi me numër C.nr.209/17 e datës 23.01.2018 e dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec C.nr.8/18 të datës 03.06.2020, kontrata e shitblerjes e datës 02.06.2015 e lidhur tek noteri R. B. së bashku me dëftesë pagesat, ka bërë shikimin e fotografive të vendit të ngjarjes, fotoalbumit me numër të rastit 2019-DHTN-315 të datës 07.05.2019, ndërsa i akuzuari H. Sh. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore është mbrojtur në heshtje, nuk është deklaruar.

Ndërsa dëshmitarët S. Sh., G. Sh. dhe E. Sh. të cilët kanë qenë të propozuar si dëshmitarë me aktakuzë, të njëjtit nuk janë dëgjuar në këtë cilësi për shkak se konform nenit 127 par.1 nënpar 1.2 të KPP-së, kanë qenë dëshmitarë të liruar nga detyrimi për të dëshmuar ngase procedura ndaj të akuzuarit H. Sh. është zhvilluar për vepër penale që mund ti shqiptohet dënimi me burgim deri në tetë (8) vite dhe të njëjtit gjatë shqyrtimit gjyqësorë kanë deklaruar se nuk dëshirojnë që të dëshmojnë në këtë çështje penale meqenëse të akuzuarin H. Sh., dëshmitari S. Sh. e ka djalë, dëshmitari G. Sh. e ka vëlla ndërsa dëshmitari E. Sh. e ka axhë.

2.1 Deklaratat e dëshmitarëve

2.1.1 Dëshmitari – A. O. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: të akuzuarin H. Sh. e njoh qysh moti meqenëse jemi të një qyteti por më shumë e njeh prej kohes kur jam punësuar në pompën “. . .”. E di që është transportues ngase të njëjtin e kam parë si shofer të kamionit. Ai ka shtuar se në afërsi të pompës ekziston një garazh dhe se me dijeninë time këtë garazhe e ka shfrytëzuar gjithë familja Sh., pra familja e ngushtë e tyre. Garazha është e ndarë në dy pjesë. Ai ka shtuar se nuk e din se çfarë tipi të kamionit vozitë i akuzuari por e di vetëm ngjyrën kamionit që është ngjyrë e gjelbërt. Ai ka shtuar se në garazhin e parë djathtas në hyrje është gjeneratori i kompanisë dhe ndonjëherë shumë rrallë kur është ndalur rryma kemi hy me ndez gjeneratorin ndërsa në pjesën e dytë të garazhit pra në anën e majtë nuk kemi pasur qasje as unë dhe as kolegët e mi. Ai ka theksuar se kamioni me ngjyrë të gjelbër zakonisht e kam parë që e ka vozit H. Sh. ngase të njëjtin e ka parkuar në të dy anët e pompës dhe se ndonjëherë e kam parë se ai kamion të bashkangjitur ka pasur cisternë të naftës. Ai ka theksuar se ditën kritike me datën 07.05.2019 gjatë ditës kam qenë duke ardhur për punë në kohën kur është bërë bastisja dhe kur jam ofruar afër pompës e kam vërejtur policinë, policia në ato momenti nuk e di se çka kanë qenë duke bërë por vetëm e kam parë se janë hyrë në shtëpinë e familjes Sh., ngase prej pompës nuk shihet në oborrin e tyre. Atë ditë një oficer policor ka kërkuar nga unë dhe juristi apo avokati i pompës që nesër të paraqitemi në Stacionin Policor në Gjakovë dhe se na ka njoftuar lidhur me rastin se

është gjetur një substancë narkotike në garazh por nuk ka cek se në cilën garazh është gjetur substanca. Ai ka shtuar se në ato pjesë të garazheve prej këndit ku kalojmë në atë pjesë shihen se kanë qenë disa aparate të derivateve dhe sipas kolegëve para meje që kanë qenë ato aparate i përkasin kompanisë tjetër para neve që ka qenë “. . .”. Ai ka theksuar se garazhet nuk kanë dyer, janë të hapura janë vetëm në shtylla dhe me kulme. Gjatë prezantimit të fotografisë me numër 3 të foto albumit ai ka theksuar se me dijeninë time kamioni “Skania” në anën e djathtë ku shihet pjesa e përparme është i G. Sh., vëllai të H., ndërsa cisterna po më duket por nuk jam i sigurtë a është e H. Sh..

2.1.2 Dëshmitari – M. B., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: H. Sh.n e njoh si qytetar meqenëse jetojmë në të njëjtin qytet në Rahovec. Me të njëjtin nuk kam pasur ndonjë raport përveçse jemi përshëndetur ndonjëherë. H.in e kam parë duke vozitë kamion por nuk më kujtohet çfarë tipi të kamionit ka vozitur por e di që është kamion me cisternë. Punoi qe 2 vite në “. . .”, jam punëtor i thjeshtë, zakonisht i mbushi me naftë veturat dhe ata që vijnë të furnizohen me naftë. Ai ka theksuar se kamioni me cisternë zakonisht ka qëndruar në garazh pra në anën e kundërt nga qyteti pra pompa është në mes pastaj është parkingu i pompës dhe në anën e kundërt është garazhi. Ai ka theksuar se kamioni i H. ka qëndruar në këtë vende siç e përshkrova më lartë. Atë ditë që kanë ardhur policia, kam qenë prezent dhe kam qenë në ndërrimin e parë dhe kur kanë ardhur policia unë kam qenë brenda në zyre dhe nuk kam dalë fare dhe nuk kam parë se çfarë veprime ka marr policia. Ai ka theksuar se kompania posedon gjeneratorë dhe se i njëjti gjendet në pjesën e majtë prej pompës pra ku është kamioni sipas fotografisë nr. 3 në pjesën e parë të garazhes. Personalisht nuk kam hyrë asnjë herë në ato pjesë të garazhes, nuk kam qenë në atë pjesë dhe nuk është marr me gjeneratorin, ngase zakonisht kur është ndalur rryma është dashur të aktivizohet gjeneratori dhe zakonisht ka shkuar kolegu imë i cili është gjithmonë në ndërrim me mua E. H. dhe ai është marr me gjeneratorin. Ai ka shtuar se po e kam kuptuar dhe krejt e kanë kuptuar se në atë garazh atë ditë është gjetur “Marihuan” pra drogë. Ai ka theksuar se këto garazhe i ka shfrytëzuar familja Sh. dhe se zakonisht garazhet i kanë shfrytëzuar gjithë familja Sh. ngase aty kamionët i ka lënë M. G. edhe H.i pra janë shfrytëzuar nga këta familjarë. Pas shikimit të fotografive 3 dhe 4 ka deklaruar se kamioni me cisternë është kamioni i H. Sh.t mendoj, ndërsa për këtë kamionin tjetër nuk e di. Në këto garazhe dyer nuk ka pasur edhe sot e kësaj dite janë të hapura.

2.1.3 Dëshmitari –M. Sh., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me H.in kam raporte të mira. Lidhur me vendndodhjen e garazhes ka deklaruar se e di ngase pompa dhe garazhet përfshihen në një parcel dhe janë në të njëjtin vend ngase pompa ka qenë pasuri e babait tonë por është e vërtetë që ne si familje kemi pasur probleme me “. . .” dhe në momentin kur kemi pasur problem kthimin e kredisë atëherë ka ndërhy pronari i “. . .” dhe e ka blerë ashtu që në ndërkohë ne e kemi blerë prej atij pompën prapë dhe i kemi të gjitha kontratat dhe pagesat të cilat i kemi kryer nga “. . .”. Po ashtu sa i përket garazheve desha të shtoj se këto garazha nuk janë larg pompës dhe ato garazha i ka përdorë “. . .” me agregat dhe është e vërtetë që ne i kemi përdorë por nën stop nuk i kemi përdorë. Ai ka shtuar se kontest civil me “. . .”, sa i përket objektit të garazheve, për momentin nuk kemi, për momentin garazha është e zbrazët, nganjëherë vëllai më i madh Gëzimi e len kamionin dhe po ashtu gjendjet edhe agregati i “. . .” që e shfrytëzojnë dhe ndonjëherë kur i shkarkojnë derivatet e naftës ata i përdorin këto garazhe. Ai ka shtuar se kamioni i tipit “Man” me tabela të regjistrimit . . . ka qenë i imi por pastaj ia kam dhënë H. për me punua, me vozitë dhe kjo është shumë se një (1) vit e gjysmë ashtu që kamioni ka qenë në emër të një firme “. . .” Rahovec ngase prej sa kemi blerë deri në ditën e sodit pra me datën 21.07.2020 ka qenë në atë emër ndërsa sot kamionin e kam përkthyer në emër “Sh. . .” Rahovec. Lidhur me pyetjet se në cilën pjesë të garazhit ka qëndruar ky kamion, ai ka theksuar se meqenëse për 2 apo 3 muaj fare nuk kam qenë në Rahovec pasi që jetoj me familjen time në Prishtinë, nuk e di se a

ka qëndruar në pjesën e djathtë apo të majtë të garazhes, pasi që në të dyja pjesët i ka pas në shfrytëzim. Për këtë rast më ka njoftuar atë ditë djali imë i vogël A. Sh., i cili ka qenë në Rahovec, tek dajat e tij dhe më ka thirr në telefon dhe më ka treguar babi kanë ardhur policia tek pompa dhe atë ditë e kam kuptuar se H.i është dyshuar për bari apo drogë që është gjetur në garazh ngase për këtë nuk kam marr veshë vetëm Rahoveci, por edhe Kosova ngase ka qenë si lajmë edhe në lajmet e mbrëmjes në televizor dhe pas dy dite më ka thirr edhe mua policia e Gjakovës për me dhënë një deklaratë lidhur me këtë rast. Ai ka shtuar se pompa dhe garazhe dhe i gjithë objekti kanë qenë nën vëzhgim të kamerave bile edhe një kamerë ka qenë e kthyer kah dyert e shtëpisë tonë edhe sot e kësaj dite dhe këto kamera janë vendosë nga “. . .”. Ai ka theksuar se vendi ku gjendet garazhet deri tek aparatet e kësaj pompe distanca është rreth 15 deri në 20 metra. Pas prezantimit të fotografisë me numër 19 të foto albumit, ai ka theksuar se ky është kamioni që e ka vozitë H. Sh. të cilin ia kam dhënë për me punua.

2.1.4 Dëshmitari E. H., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se : H. Sh.n e njoh vetëm si fqinjë ngase punoj në “. . .” që dy vite. Shtëpinë H.i e ka pasur përballë rrugës dhe ndonjëherë e kemi pasur edhe si klient i cili është furnizuar me derivate me veturë, ndonjëherë edhe me kamion, por ka qenë klient edhe në maketin e pompës. Në përgjithësi me të kemi kaluar shumë mirë dhe nuk kemi pasur ndonjë problem me të. Me datën 07.05.2019 kam qenë në orarin e punës përkatësisht kam qenë në oborr pra në anën e kundërt ku ka ndodhur bastisja. Vetëm kam qëndruar aty dhe kam pritur klientë për çdo rast. I kam parë policinë dhe e kam parë që ka qenë një intervenim i shpejtë pasi që policia kanë hyrë tek shtëpia e familjes Sh. dhe tek garazha. Menjëherë kur ka ndodhur bastisja më është dukur diçka interesant dhe jam tërheq dhe kam hyrë brenda në market dhe nuk e di se çka ka ndodhur më pas. Përderisa kam qenë një punëtor i thjeshtë, nuk më ka interesuar pronësia e kësaj garazhe dhe as sot e kësaj dite nuk e di dhe nuk më ka interesuar që ta di. Zakonisht kur kam kaluar andej për të shkuar në punë, i kam parë që në garazhë kanë qenë kamionat e familjes Sh.. Aty është një objekt i madh dhe i ka disa shtylla por nuk e di se si është dhe pjesët anësore i ka të mbyllura. Qasje kemi pasur vetëm në momente të caktuara, kur është ndalur rryma së bashku me menaxherin i kam ndihmuar që ta ndezim agregatin i cili gjendet në një qoshe në hyrje të garazhit. Unë si person e marr punën me seriozitet dhe kur kam shkuar që ta ndezi agregatin, jam marr vetëm me agregatin dhe nuk kam shikuar se çka gjendet tjetër në ato garazha. H.in e kam parë duke vozitur një kamion me cistern të cilin e ka parkuar në ato garazha dhe përveç tij nuk e kam parë dikë tjetër. Ditën kritike me sa e mbaj mend e kam takuar H.in në mëngjes diku rreth orës 08:00/h ose 09:00/h e mëngjesit sepse është furnizuar në pompë me derivate të naftës me një makinë të vogël. Nuk kam biseduar me të pasi që është rregull i kompanisë që të mos bisedojmë me klientë. Nga ana e policëve dhe kolegëve e kam dëgjuar se atë ditë në ato garazha është gjetur drogë, por për në shtëpi nuk kam dëgjuar se është gjetur diçka. Nuk më kujtohet se kur ka qenë hera e fundit para ditës kritike kur e kam parë për herë të fundit H.in duke dalë me kamion nga garazha. Në pompën ku punoj ka kamera sepse edhe ditën e parë kur kam hyrë në punë na kanë njoftuar se ka kamera. Pamjen se si e kapin kamerat saktësisht nuk e di por e di që një kamerë është vendosur afër bocës së plinit dhe është afër garazhës. Nuk jam në dijeni se në këtë pompë është vjedhur diçka në garazha dhe se është denoncuar rasti. Në këto garazha i kam parë në përgjithësi të gjithë familjarët e familjes Sh..

2.1.5 Dëshmitari B. T., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se : jam vozitës, përkatësisht tregtar i firmës “. . .” në Rahovec. Posedoj dy mjete transportuese përkatësisht dy kamionë, një të tipit “Aktras” dhe një të tipit “Skani” dhe tani e kam blerë edhe një të tipit “Man”. E njoh personin me emrin M. Sh., me të nuk më lidh asgjë por më përpara kemi udhëtuar rrugës për Serbi. Kamionin e tipit “Man” ia kam shitur para 3 viteve M. Sh.t. Çmimi ka qenë rreth 7000 euro dhe ia kam shitur vetëm kokën e kamionit që ka qenë ngjyrë e gjelbër. Kamioni ka qenë në emër të firmës dhe jemi marrë vesh që kur t’i dale regjistrimi t’ia regjistrojmë në emër të tij. Përktimi nuk është bërë pasi që marrëveshja ka qenë që së pari të bëhet pagesa e shitjes e pastaj

të bëhet bartja e kamionit. M. ma ka bërë vetëm gjysmën e pagesës ngase nuk e ka respektuar marrëveshjen. Për pjesën tjetër e di që H.i ka ardhur tek unë dhe më ka thënë se M. ma ka dhënë kamionin mua dhe unë e marr obligim për pjesën tjetër që ta paguajë dhe deri sa mi ka dhënë H.i këto pare kemi pasur telashe të mëdha vetëm sa nuk jemi rreh dhe i njëjti e ka paguar në tërësi pjesën tjetër të borxhit me njëqind telashe. Nuk kemi bërë kontratë me shkrim për këtë shitblerje dhe kur i ka dalë regjistrimi ai më ka lutur që ta regjistroj edhe njëherë kamionin në emrin tim pasi që kinse ka pasur problem me banka dhe unë i kam besuar dhe ka vazhduar regjistrimin në emrin e firmës time pasi që kam dashur që ti ndihmojë. Kur e kam shitur në fillim këtë kamion e ka vozitur M. dhe djali i tij ndërsa më vonë nuk e di ngase unë tërë kohën jam në rrugë me punët e mia me biznesin tim. E kam parë edhe H.in duke e vozitur atë kamion. Absolutisht asnjëherë H.i nuk ka punuar si shofer tek firma jonë, pasi që merrem vetë me këtë punë dhe kam edhe vëllain. Me të kemi pasur punë vetëm sa i përket shitblerjes së kamionit dhe gabimi im më i madh është se nuk e kam bërë përkthimin me kohë duke i bërë nder dhe sot e kemi përkthimin e kamionit në emër të M. Sh.t pas asaj kohe. Pas prezantimit të fotografisë në fotoalbumin me numër 19, ai ka theksuar se ky është ai kamioni me atë regjistrim edhe pse ngjyra nuk i paska dalë mirë në foto.

2.1.6 Dëshmitari H. Z. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: të akuzuarin e njoh që nga viti 1987 apo 1988 dhe për herë të parë bashkëpunimin me të e kam filluar mund të them para një viti e gjysmë, ku kam qenë punëtor i tij përkatësisht kam qenë si ndihmës në ngarkimin dhe shkarkimin e derivative të naftës me të cilën furnizohej nga Shqipëria. Paga ka qenë ditore 15 Euro. Transportin e naftës e kemi bërë ne, saktë nuk e di llojin e tij, por më duket se ka qenë e tipit Man, ngjyre e gjelbër, ndërsa cisterna ka pasur ngjyrë hiri. H.i me derivate të naftës i furnizonte pompa të ndryshme si “Kastrati” në Malishevë dhe pompa tjera të ndryshme në Prishtinë, të cilat nuk më kujtohen. Ditën kur është arrestuar H.i nga policia me datën 07.05.2019 më duket se kam qenë në Prishtinë, ngase atë ditë kam shkuar me H.in me veturën time Golf 4, ngjyrë e zezë, me tabela të regjistrimit 01-738-IL, e pastaj jam kthyer vetë. Atë ditë rreth orës 08:30 minuta, më ka thirrë H.i dhe ka kërkuar që të takohemi diku ashtu që pas 10 minutave jemi takuar me H.in i cili kërkoj nga unë që ta dërgoi deri në Prizren për disa punë të tija pasi që automjetit të tij i kishte skaduar regjistrimi. Nuk më kujtohet numri i telefonit të H. dhe tani nuk e kam të regjistruar më por atë ditë kur më ka thirrë H.i për ta dërguar në Prizren me automjetin tim kam kontaktuar shumë herë me Viber. H.i më duket se ka pasur një automjet të tipit Ford dhe nuk më kujtohet se ku e ka lënë atë ditë para se të nisemi për në Prizren. Nuk më kujtohet që kam pasur në automjetin tim ndonjë gjë që i ka takuar H., kur jemi kthyer nga Prishtina për në Rahovec dhe nuk më kujtohet se e ka lënë jaknen apo telefonin e tij ngase unë me telefon kam kontaktuar me H.in. Ai ka theksuar se duke shkuar për në Prishtinë, e di se jemi ndalë tek disa ndërtesa në Fushë Kosovë të cilat kanë qenë të pa banume dhe nuk më ka treguar se ku është duke shkuar. Ai ka theksuar se meqenëse kamë dhënë deklaratë në polici dhe ngjarjen e kam pasur më të freskët e vërteta është ajo çka kam thënë në polici ngase ka ndodhur shumë shpesh që unë me e marr H.in dhe me u takua me të dhe tani ndoshta nuk po më kujtohet prandaj e vërteta është ajo që e kam dhënë në polici. Nuk e di se ku e linte H.i kamionin e tij me cisternë pasi e përfundonte punën. Kur shkonim për të marrë naftë në Shqipëri, niseshim zakonisht në dy pika, daljen për në Suharekë dhe daljen për në Xërxë dhe zakonisht kamionin H.i e linte te pompa, në të cilin vend unë nuk kam qenë asnjëherë sepse aty ka qenë pronë private dhe nuk kam pas çka me lyp aty. Unë nuk kam dëgjuar me datën 07.05.2019 që tek pompa e benzinës policia kanë bërë kontrollin dhe bastisjen e garazhës në afërsi të pompës si dhe në shtëpinë e të akuzuarit H. Sh. dhe as nuk kam dëgjuar se atë ditë është arrestuar H.i por më vonë jam njoftuar prej shoqërisë. Kur kemi shkuar në Shqipëri për të marrë naftë kemi kaluar në pikën kufitare Morinë kah Vermica. Në pikën doganore policia apo zyrtarë policorë kanë bërë kontrole ndonjëherë edhe me skaner. Në Shqipëri kemi shkuar në Durrës dhe Ballsh për t’u furnizuar me

derivate dhe çdo herë kam qenë bashkë me H.in. Kam punuar me H.in për ngarkim dhe shkarkim të derivateve por të njëjtin e kam ndihmuar edhe nëse ka pasur ndonjë prishje, por mjeshtër nuk jam. Me H.in kam bashkëpunuar një kohë të shkurtë dhe të gjitha shpenzimet e udhëtimit i ka paguar ai. Hera e fundit kur kemi marr naftë ka qenë diku 3 javë përpara se të dëgjoja për arrestimin.

2.1.7 Dëshmitari F. L. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se : jam avokat pranë Odës së Avokatëve të Kosovës. Punoj si avokat i jashtëm i pikës së karburantit “. . .”. Kjo e fundit kur ka kuptuar që në garazhe që ndodhet ngjitur me pompën e që është në pronësi të “. . .”, e cila mbahet në shfrytëzim pa leje të kompanisë nga familja Sh. , të cilët i parkojnë kamionët dhe kanë vendosur disa gjëra të tyre nga pjesa e pompës e cila ka qenë më herët, me kërkesën e kompanisë kam shkuar në polici dhe i kam njoftuar për konteste civile të cilat i ka kompania me familjen Sh., iu kam dorëzuar edhe disa dokumente të cilat kanë qenë padi dhe dokumentet tjera të lëndëve civile. “. . .” pronën e ka blerë nga Banka Ekonomike dhe nëse nuk gaboja ka qenë në vitin 2015, mirëpo theksoj se unë në atë kohë nuk kam qenë avokat i kësaj kompanie. Banka Ekonomike këtë paluajtshmëri e ka marrë në procedure përmbareme nga familja Sh. dhe kur ka ndodhë blerja nga “. . .” prej Bankës Qendrore kanë pasur vështirësi për shfrytëzimin e saj prej pjesëtarëve të familjes Sh.. Pjesën e garazheve asnjëherë nuk e ka marrë në shfrytëzim kompania për të cilën pjesë vazhdojmë për të qenë në procedura kontestimore pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec. Në vendin ku gjendet pompa është një pjesë e veçantë e ndarë ku në ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë që e kemi marrë në procedurë civile sqarohet se brenda paluajtshmërisë gjendet edhe një pjesë e cila është garazhe dhe e cila është pjesë e veçantë nga pompa e derivateve. Tek pika e karburantit e cila është disa metra larg garazhe është edhe një hapësirë ku është zyrë e cila mbikëqyret nga menaxheri i asaj pike të cilit menaxher ia di emrin por për momentin nuk më kujtohet por më duke që mbiemrin e ka O. por unë nuk kam punë në këtë kompani me menaxherët e pikës apo të pikave tjera të kësaj kompanie. Tek garazhat kam kaluar disa herë por asnjëherë nuk jam ndalur. Para se ta blejë “. . .” nga B.E. aty ka qenë si pompë “. . .” dhe në bazë të informacioneve që kam nga stafi i “. . .”, pajisjet që janë aparaturat për mbushjen me derivate, të gjitha janë vendosur të reja nga “. . .” ndërsa ato të vjetrat nuk i ka pasur në posedim, të njëjtat janë hequr dhe nuk e di se ku janë. Unë sa herë kam kaluar andej kam parë kamionë ngase aty ka hapësirë për dy kamiona dhe në brendësi nuk e di se çka ka pasur. Kamionët nuk kanë qenë të “. . .” pasi siç e theksova ata nuk e kanë pasur këtë pjesë në shfrytëzim sepse nuk është lejuar nga familja Sh. dhe sipas punëtorëve të kësaj pike të “. . .” jam njoftuar se kamionët janë të familjes Sh.. Sa i përket fotografisë ku shihet se në garazhe kanë qenë kamionët e “. . .”, e e cila fotografi është bërë tre ditë pas shqyrtimit gjyqësor të datës 30.07.2020, për këtë më së miri mund të përgjigjet menaxheri apo punëtorët. Theksoj se punëtorët e kompanisë nuk kanë pasur qasje asnjëri në këto garazhe dhe disa herë kanë pasur problem me familjarët e familjes Sh. për çka janë inicuar procedurat penale. H. Sh.n e njoh vetëm si emër dhe atë nga dosjet e vjetra që kanë qenë ndaj tij sepse është ngritur një aktakuzë për vendosjen e shiritave të pompës. Sa i përket faktit se “. . .” paluajtshmërinë ia ka shitur G. Sh.t, dua të sqaroj se “. . .” i ka kthyer të gjitha mjetet mbrapshtë në llogarinë nga e cilat i ka pranuar mjetet, nga një firmë “Sh.” dhe lidhur me këtë çështje siç deklarova edhe më parë kompania është edhe në kontest në gjykatën e lartpërmendur. Nuk jam në dijeni se me datën 3, 4, 5, 6 dhe 7 nuk kanë funksionuar kamerat, nuk e di kur i menaxhon ato apo kur është IT për kamera.

2.2 Provat materiale

2.2.1 Nga leximi i raportit të oficerit Sh. S. me numër të rastit 2019-DHTN-315 i datës 07.05.2019, gjykata ka konstatuar se në këtë raport janë përshkruar veprimet hetimore që ka ndërmarr oficeri Sh. S. në të cilin ka konstatuar se me datën 07.05.2019 rreth orës 14:10 minuta,

ka filluar bastisja e personit H. Sh. që për të njëjtin kishin informata për shitblerjen e narkotikut të llojit “marihuanë”, ashtu që gjatë bastisjes prezent si dëshmitarë kanë qenë S. Sh. dhe E. Sh.. Fillimisht është bërë kontroll në shtëpi dhe lokalet përcjellëse në oborrin e shtëpisë pastaj kemi dalë në rrugë kryesore, përballë ishte një garazh, në garazhe ishte i parkuar një kamion “Man” me targa të regjistrimit . . . në të cilën fillimisht kemi bërë kontrollën e kamionit në të cilin nuk është gjendur asgjë e dyshuar brenda tij. Brenda garazhit ku ishte kamioni prapa makinave të pompës së derivateve të fSh.ra kemi gjetur 3 paketime të mëdha me ngjyrë të zezë brenda të cilës kishte substancë në formë bari e dyshuar për narkotik të llojit “marihuanë”, e cila është konfiskuar ku në këtë raport janë shënuar edhe sasia dhe pesha e narkotikut të konfiskuar.

2.2.2 Nga leximi i dëftesës për konfiskimin e pronës me numër të rastit 2019-DHTN-315 i datës 07.05.2019, gjykata ka konstatuar se nga ana e policisë ishin konfiksuar tri dëshmi që kishin qenë të mbushura me bari i ngjyrës gjelbër e cila ishte dyshuar si “marihuanë”, ashtu që dëftesën për konfiskim të pronës i akuzuari kishte refuzuar ta nënshkruaj me arsyetimin se narkotiku nuk ishte i tij.

2.2.3 Nga leximi i procesverbalit mbi bastisjen e banesës dhe personave të datës 07.05.2019, gjykata ka vërtetuar se bastisja ishte bërë me datën 07.05.2019, me fillim në ora 14:10 minuta dhe kishte përfunduar në ora 15:50 minuta, ku si dëshmitarë gjatë bastisjes kishin qenë S. Sh. dhe E. Sh. dhe gjatë bastisjes dhe në këtë procesverbal është konstatuar se në garazhin të cilin e shfrytëzonte H. Sh. janë gjetur paketime të zeza të mëdha të mbushura me substancë narkotike e cila dyshohet se është “marihuanë”.

2.2.4 Nga leximi i raportit plotësues i oficerit Sh. S. me numër të rastit 2019-DHTN-315 i datës 25.07.2019, gjykata ka konstatuar se gjykata ka konstatuar se në këtë raport janë përshkruar veprimet hetimore që ka ndërmarr oficeri Sh. S..

2.2.5 Nga leximi i raportit të këqyrjes në vendin e ngjarjes me numër të rastit 2019-DHTN-315 i datës 07.05.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se njësia e forenzikës ditën kritike me datë 07.05.2020 kishte dalë në vendin e ngjarjes në rrugën “. . .” në Rahovec, në afërsi të “. . .” përball shtëpisë së të akuzuarit H. Sh., në anë të majtë të rrugës në drejtim të fshatit Xërxë, Komuna e Rahovecit, ashtu që nga ana tyre ishte konstatuar se vendi i ngjarjes ishte garazh të cilën e përdorte për të parkuar kamionin e tij i akuzuari H. Sh., ashtu që nga ana e tyre ishin bërë fotografitë e vendit të ngjarjes brenda dhe jashtë objektit, janë bërë fotografi mbi pozitën e gjetjes së dëshmive dhe evidentimi i tyre ashtu që: me D#1 është evidentuar çantë e zezë e cila pas kontrollit kishte 30 kg e 400 gr substancë narkotike të llojit “marihuanë”, me D#2 është evidentuar çantë e zezë e cila pas kontrollit kishte 20 kg e 400 gr substancë narkotike të llojit “marihuanë”, me D#3 është evidentuar çantë e zezë e cila pas kontrollit kishte 16 kg e 200 gr substancë narkotike të llojit “marihuanë”, të cilat dëshmi janë konfiskuar nga DHTN në Gjakovë, ashtu që nga fotoalbumi që i është bashkangjitur këtij raporti shihet vendi i ngjarës si dhe vendi ku janë gjetur dëshmitë e lartshënuara.

2.2.6 Nga leximi i raportit mbi ekzaminimin e substancës narkotike të përpiluar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë në Prishtinë, me numër AKF/2019-2168-2019-1131, të datës 09.10.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se në 3 çantat të cilat kishin qenë të mbushura substancë narkotike të llojit “marihuanë” të cilat janë gjetur në garazhin të cilën e shfrytëzonte i akuzuari H. Sh. i cili ditën kritike e kishte të parkuar kamionin e tij, e të cilat janë evidentuar si dëshmi D#1, D#2 dhe D#3 nga mendimi përfundimtar ka rezultuar dhe treguar se kjo substancë përmban Kanabis (Marihuanë), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme prej 63200±0.0001 gram.

2.2.7 Nga leximi i raportit të oficerit A. B. i datës 02.09.2019 me numër të rastit 2019-DHTN-315, së bashku me fotoalbumin me të njëjtin numër dhe me të njëjtën datë, gjykata ka vërtetuar faktin se me datën 02.09.2020 është bërë bastisja dhe kontrolli i veturës “Ford Fiesta”, pronë e të akuzuarit H. Sh., ashtu pas gjatë kontrollit nuk është gjetur asgjë e dyshuar në veturë.

2.2.8 Nga leximi i raportit të ekspertimit të Agjensisë së Kosovës për Forenzikë me numër AKF-201-1268-2019-1128 i datës 21.06.2019 i gjurmëve latentë të vijave papilare të gishtërinjve, gjykata ka vërtetuar faktin se D#1, D#2 dhe D#3 nuk është nxitu asnjë gjurmë e vijave papilare.

2.2.9 Nga leximi i raportit plotësues i oficerit Sh. S. të datës 23.06.2020, së bashku me CD-në, gjykata ka konstatuar se në këtë raport nga ana e oficerit Sh. S. është bërë përmbledhja e regjistrimeve të kamerave të sigurisë së pompës “. . .” në Rahovec, ashtu që ka bërë përshkrimin e datës 01.05.2019 gjatë ditës ku shihet i akuzuari duke punuar në garazhin përkatësisht në vendin e ngjarjes ku është gjetur substancë narkotike të llojit “marihuanë”, ku është bërë përshkrimi sipas fotografive që janë nxjerr nga video-inqizmi, e cilat shihen edhe nga video-ingjizmi në CD. Po ashtu është bërë përshkrimi i datës 07.05.2019 ku është bërë përshkrimi sipas fotografive që janë nxjerr nga video-inqizmi, e cilat shihen edhe nga video-ingjizmi në CD. Gjithashtu në këtë raport është konstatuar se edhe pse kemi bërë me kohë kërkesë për nxjerrjen e video-inqizimeve nga kompania “. . .” pasi kemi marr të regjistruara në USB nga zyrtari përgjegjës i IT-së, nuk kanë qenë datat 03, 04, 05, dhe 06.05.2019 por vetëm 07.05.2019.

2.2.10 Nga leximi i padisë për lirimin e pronës së dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, me numër të lëndës C.nr.225/2013, padisë për vërtetimin e pronës dhe anulimin e kontratës e datës 17.06.2019 e dorëzuar Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, kundërpadisë me numër C.nr.209/17 e datës 23.10.2019 e dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, i përgjigjes në padi me numër C.nr.209/17 e datës 23.01.2018 e dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec C.nr.8/18 të datës 03.06.2020, gjykata nga të gjitha këto ka vërtetuar faktin se në mes të kompanisë “. . .” dhe N.N.T.SH.T “Sh.” Rahovec, ku si pronar ishte G. Sh. edhe Sh., janë duke u zhvilluar procedurat kontestimore sipas këtyre padive në Gjykatën Themelore në Gjakovë-dega në Rahovec, ku kompania “. . .” kishte kërkuar lirimin e pronës përkatësisht garazheve nga familja Sh., ndërsa familja Sh. kishte kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe anulimin e kontratës së hipotekës.

2.2.11 Nga shikimi i fotografive të vendit të ngjarjes dhe nga shikimi i fotoalbumit me numër të rastit 2019-DHTN-315 i datës 07.05.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se në këto fotografi shihet vendi i ngjarjes përkatësisht garazhi dhe tri (3) çanta të cilin janë gjetur në vendin e ngjarjes prapa makinave të pompës së derivateve të fSh.ra, të cilat janë vërtetuara se kanë qenë të mbushura me substancë narkotike të llojit marihuanë, të cilat janë identifikuar nga policia si dëshmia D#1, D#2 dhe D#3. Gjithashtu në foto vërtetohet se ditën kritike në këtë garazh ka qenë i parkuar kamioni i tipit “Man” me tabela të regjistrimit . . . së bashku me cisternë pronë e të akuzuarit H. Sh.. Po ashtu nga fotografit me numër 7 dhe 8 të këtij fotoalbumi gjykata ka vërtetuar faktin se ndërmjet dy garazheve kishte mure ndarës në pjesën ku është gjetur narkotiku. Në këto fotografi shihet se është bërë edhe matja e sasisë së substancë narkotike në vendin e ngjarjes nga ana e Zyrtarëve Policorë të Njësitit për Krim Teknik.

2.2.12 Nga shikimi i shikimi i CD-së - video incizimeve të vendit të ngjarjes, gjykata ka vërtetuar faktin se në këtë video incizime shihet, vendi ngjarjes përkatësisht garazhi në të cilin

janë gjetur tri (3) çanta me substancë narkotike të llojit marihuanë e të cilën garazh e shfrytëzonte i akuzuari H. Sh., e në veçanti përmes këtyre video incizimi gjykata ka vërtetuar se garazhi ishte i ndarë në dy pjesë me mure ndarës dhe vetëm në fillim në hyrje të këtyre dy pjesëve garazheve nuk kishe mure.

2.2.13 Nga shikimi i CD-së nga hartografia, gjykata ka vërtetuar faktin se ishin nxjerr hartografia nga numri i telefonit të akuzuarit.

2.3 Mbrojtja e të akuzuarit

2.3.1 I akuzuari H. Sh., gjatë shqyrtimit gjyqësor, në fazën e mbrojtjes ka deklaruar se i kam kuptuar të drejtat e mia dhe në konsultë me mbrojtësin tim av.H. M. deklaroi se e shfrytëzoi të drejtën që të mbrohem në heshtje në këtë fazë të procedurës.

3.Elementet e veprës penale

Në nenin 267 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge: *“Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet”*

4.Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata, ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se, nuk mund t'i falet besimi mbrojtjes së të akuzuarit H. Sh., i cili ka mohuar kryerjen e veprës penale ngase sipas vlerësimit të gjykatës kjo është bërë thjeshtë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe se mbrojtja e tij është në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve A. O. M. B., E. H., B. T. dhe F. L., të cilëve gjykata iu ka falur besimin dhe po ashtu mbrojtja e tij është në kundërshtim të gjitha provat të cilave gjykata po ashtu iu ka falur besimin, siç janë: raporti i oficerit policor Sh. S. me numër 2019-DHTN-315 i datës 07.05.2019, dëftesa mbi konfiskimin e pronës me numër 2019-DHTN-315 i datës 07.05.2019, procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave të Stacionit Policor në Gjakovë i datës 07.05.2019, raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes me numër të rastit 2019-DHTN-315 të datës 07.05.2020, raportin mbi ekzaminimin e substancës narkotike të Agjencisë së Kosovës së Forenzikës në Prishtinë, raporti i oficerit policor A. B., me numër 2019-DHTN-315 i datës 02.09.2019, raportin plotësues të oficerit policor Sh. S. me numër 2019-DHTN-315 i datës 23.06.2020 së bashku me CD-në, foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës si dhe me shikimin e CD-ve të vendit të ngjarjes. Për Gjykatën, nga provat e lartpërmendura të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor e të cilave gjykata iu ka falur besimin nuk është kontestuese fakti se tek i akuzuari H. Sh., gjatë bastisjes së garazhit të tij të cilën e kishte në posedim dhe e shfrytëzonte janë gjetur dhe sekuestruar tri (3) paketime (çanta) të mbushura me substancë narkotike e llojit “Marihuanë” në peshë prej 63 kilogram e 200 gram në të cilin garazh ditën kritike e kishte të parkuar edhe kamionin e tij të markës “Man”, me targa të regjistrimit . . . kjo vërtetohet nga procesverbali mbi bastisjen, dëftesa mbi konfiskimin e pronës, raporti i oficerit Sh. S. dhe raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes.

Po ashtu për gjykatën nuk është kontestuese fakti se i akuzuari substancën narkotike të llojit marihuanë e kishte për qëllim shitje ngase kjo vërtetohet nga provat e lartpërmendura, e

veçanti nga sasia e gjetur e narkotikut dhe mënyra se si akuzuari ka kryer veprën penale, ku i njëjti në garazhin të cilën e kishte në posedim dhe e shfrytëzonte për punë dhe parkonte kamionin e tij të markës “Man” së bashku me cisternë, tre (3) paketimet (çantat) me ngjyrë të zezë, të cilat ishin të mbushura me narkotik të llojit “marihuanë”, i kishte fSh.r prapa aparateve-makinave të pompës së derivateve të cilat gjendeshin kohë më parë në atë garazh ashtu që narkotikun e kishte vendos në mes murrin dhe aparateve, e kur merret parasysh sasia e gjetur e narkotikut prej 63 kilogram e 200 gram, këto prova vërtetojnë faktin se i njëjti e kishte përgatitur substancën narkotike të llojit marihuanë për qëllim të shitjes. Po ashtu nga raporti i ekspertimit mbi substanca narkotike të Agjencisë Kosovare për Forenzikë të datës 09.10.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se në tri (3) paketimet (çantat) të cilat kanë qenë të mbushura me substancë narkotike që janë evidentuara si D#1, D#2 dhe D#3, e të cilat janë gjetur ditën kritike në garazhin e të akuzuarit H. Sh., të cilin e shfrytëzonte, ka rezultuar se substanca narkotike e konfiskuar tek i akuzuari përmban Kanabis (Marihuanë), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) dhe është me peshë neto të përgjithshme prej 63200 ± 0.0001 gram.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit, ku sipas tij me administrimin e provave nuk është vërtetuar identiteti objektiv dhe subjektiv i akuzës ngase çështja kryesore mbi faktin se ku u gjet narkotiku, sasia dhe lloji sipas ekspertizës në të cilën thirret prokuroria, vlen pyetja a ishte kamioni “Man”, i gjelbër, a ishte kamioni cisternë, që në rrethanën e dëshmimeve që iu prezantua gjykatës lidhur me faktin se kush ishte vozitësi i kamionit ku si provë kryesore ishte vendi i ngjarjes, raporti mbi bastisjen në garazhin ku kanë qasje jo vetëm punëtorët e “. . .” ku e kanë të vendosur agregatin –gjeneratorin e rrymës dhe faktin se fotoja nga procesverbali i dëgjimit të dëshmitari Av.L., u vërtetua se kamioni i “. . .” ishte në atë garazhe ku u gjet narkotiku, e cila garazhe nuk ka hyrje dhe dyer. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky pretendim i mbrojtjes është i pabazuar për faktin se për gjykatën fillimisht nuk ka qenë kontestuese fakti i akuzuarit e kishte kryer veprën penale për të cilin ngarkohet me akuzë ngase gjykata edhe ka dhënë arsyet e lartë përmendura për të cilat edhe ka vërtetuar fajësinë tij. Po ashtu lidhur me pretendimet tjera jep arsyet si në vijim. Për gjykatën fare nuk ka qenë kontestues fakti se kamioni markës “Man”, me targa të regjistrimit . . . së bashku me cisternë kanë qenë pronë e të akuzuarit H. Sh., i cili kamion ditën kritike është gjendur i parkuar në vendin ku është gjetur substanca narkotike e llojit “marihuanë” pra kamioni ishte i parkuar, pastaj ishin aparatet e derivateve të naftës dhe prapa tyre kanë qenë të fSh.ra tre (3) paketimet (çantat) me ngjyrë të zezë, të cilat ishin të mbushura me narkotik të llojit “marihuanë”. Gjithashtu nuk ka qenë kontestuese fakti se parcela në të cilën gjendeshin këto dy garazhe ishin pronë e Kompanisë “. . .”, të cilën pronë familja Sh. e kishte lënë nën hipotekë . . . e të cilin me pas “. . .”, kishte blere përmes ankandit publik. Po ashtu për gjykatën nuk ka qenë fare kontestuese që nga koha kur e kishte blerë këtë pronë “. . .”, edhe pse garazhet të cilat gjendeshin në këtë parcel e cila ishte pronë e “. . .”, familja Sh. të njëjtat garazhe ka vazhduar që ketë në posedim dhe shfrytëzim të tyre e për të cilën çështje ishin të iniciuara edhe procedurat kontestimore për lirimin e pronës dhe kjo vërtetohet nga shkresat civile të cilat gjykata i ka administruar si provë e të cilat janë të konstatuara si në pikën 2.2.10 të këtij Aktgjykimit. Po ashtu nuk ka qenë fare kontestuese fakti se garazhin përkatësisht vendin ku janë është gjetur substanca narkotike e shfrytëzonte dhe punonte i akuzuari H. Sh..Po ashtu për gjykatën nuk ka qenë kontestues fakti se në hyrje të garazheve nuk kishte dyer ngase kjo vërtetohet edhe nga foto dokumentacioni dhe video incizimet e vendit të ngjarjes. Mirëpo pretendimi i mbrojtjes se në këto garazhe kishin qasje edhe punëtorët e “. . .”, sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim është i pa bazuar ngase është në kundërshtim me dëshminë e dëshmitarëve përkatësisht punëtorëve të kësaj kompanie, ngase dëshmitari A. O. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar *“se në pjesën e dytë të garazhit pra në anën e majtë nuk kemi qasje as unë dhe as kolegët e mi dhe se këtë garazh e ka shfrytëzuar familja Sh. pra familja e ngushtë dhe se H.i e parkonte kamionin me cisternë në këtë garazh”*.

Po ashtu edhe dëshmitari M. B. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se *“kamioni dhe cisterna kanë qëndruar në këtë garazh dhe ka theksuar se personalisht nuk kam hyrë asnjë herë në ato pjesë të garazheve. Po ashtu dëshmitari E. H. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar: “se qasje kemi pasur vetëm në momentet të caktuara kush është ndalë rryma me menaxherin i kam ndihmuar që ta ndezim agregatin i cili gjendjet në një qoshe të garazhit. H.in e kam parë duke vozitur një kamion me cistern të cilin e ka parkuar në ato garazha dhe përveç tij nuk e kam parë dikë tjetër”*. Po ashtu dëshmitari F. L. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se *“pjesën e garazheve asnjëherë nuk e ka marrë në shfrytëzim kompania për të cilën pjesë vazhdojmë për të qenë në procedura kontestimore pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec”*, prandaj edhe gjykata dëshmisë se këtyre dëshmitarëve iu ka falur besimin e plotë, për shkak se dëshmitë e këtyre dëshmitarëve janë në harmoni me njëra tjetrën dhe përmes tyre ka vërtetuar faktin se nuk kishin qasje në këto garazhe e në veçanti pjesën e garazhit ku janë gjetur narkotiku. Ndërsa sa i përket fotografisë së prezantuar nga mbrojtësi i të akuzuarit gjatë dhënies së dëshmisë së dëshmitarin F. L., gjykata këtë fotografi ku shihet kampioni i “. . .”, i parkuar në garazh e konsiderojë si shumë irelevante dhe jo të rëndësishme ngase kjo fotografi është bërë me qëllim të krijimit të konfuzionit ngase vetë mbrojtësi ka sqaruar se kjo fotografi ishte bërë tri ditë pas shqyrtimit gjyqësor të datës 30.07.2020, pra shumë kohë pas rastit pra ditës kritike. Se i akuzuari e shfrytëzonte këto garazhe për punët e tij edhe e parkonte kamionin e tij në këtë vend gjykata këtë e ka vërtetuar edhe nga raporti plotësues i datës 23.06.2020 i oficerit Sh. S. në të cilin përmes fotografive ka bërë përshkrimin e datës 01.05.2019 ku shihet i akuzuari H. Sh. së bashku me djalin e vëllait të tij E. Sh.. Gjukata ka video incizimin në CD ka vërtetuar se në video ngjizim të datës 01.05.2020 shihet se garazhi ishte i ndarë në dy pjesë me murr ndarës dhe vetëm në fillim në hyrje të këtyre dy pjesëve të garazheve nuk kishte mur dhe nga vendi ku pretendohet se ka qenë agregati dhe vendit ku është gjetur narkotiku është një distancë dhe është muri ndarës dhe po ashtu shihet se brenda tyre ishin të parkuar kamioni i të akuzuarit H. Sh. në pjesën ku është gjetur narkotiku dhe në pjesën tjetër kamioni i vëllait të akuzuarit G. Sh.. Prandaj për gjykatën fare nuk ka qenë kontestuese fakti se në garazhin ku janë gjetur narkotiku e kishte në posedim dhe shfrytëzim i akuzuari H. Sh. dhe nuk kanë pasur qasje personat tjerë siç pretendon mbrojtja.

Sa i përket pretendimit të mbrojtësit se pyetjet janë bërë vetëm rreth kamionëve, sipas vlerësimit të gjykatës këto pyetje janë bërë edhe nga ana e vetë gjykatës ngase i akuzuari H. Sh. në deklaratën e dhënë në Prokurori Themelore në Gjakovë në prezencën e mbrojtësit av.H. M., por edhe në Stacionon Policorë nga Gjakovë në prezencën e mbrojtësit av.Prek Pepaj, kishte deklaruar *“se garazhet kishin qenë pronë e “. . .” dhe se nuk ishin në shfrytëzim të tij. Po ashtu ka deklaruar se punon për firmën private “. . .” në Rahovec, të cilën edhe e vozit kamionin “Man” me targa të regjistrimit . . . që është në emër të firmës “. . .”pronë e tyre dhe se kamionin e vozisin edhe shoferat tjerë të kësaj firme, prandaj gjykata konsideron këto pyetje janë bërë duke marrë për bazë deklaratat tij të mëparshme të cilave gjykata nuk iu ka falur besimin ngase konsideron se i akuzuari këto deklarime i kishte bërë me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale dhe deklaratat e tilla ka qenë në kundërshtim me të gjitha provat dhe dëshmitarët e lartpërmendur të cilëve gjykata iu ka falur besimin. Në këtë drejtim se i akuzuari përmes deklaratave të tij në PTH dhe Polici është munduar që ti ikë përgjegjësisë penale vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit B. T. të dhënë në shqyrtim gjyqësor i cili ka deklaruar se: *“absolutisht asnjëherë H.i nuk ka punuar si shofer tek firma jonë pasi që unë punoi vetë së bashku vëllain. Me H.in kam pasur punë vetëm sa i përket shitblerjes së kamionit dhe ka qenë gabimi imë më i madhe që nuk e kam bërë me kohë përkthimin e kamionit, duke munduar ti bëjë nderë. H.i ka ardhur tek unë dhe më ka thënë se M. më ka dhënë mua kamionin dhe unë marr obligimin për pjesën tjetër për ta paguar borxhin dhe derisa më ka dhënë H.i këto para kam pasur telashe të mëdha vetëm sa nuk jemi rreh dhe i njëjti ma ka paguar në tërësi borxhin e kamionit”*. Prandaj edhe gjykata ia*

ka falur besimin dëshmitarit B. T., ngase konsideron se i akuzuari H. Sh. për ti ikur përgjegjësisë penale ka dashur që ta ngarkoi kompaninë “. . .”, duke thënë se ishte shofer i tij ngase kamioni ditën kritike ishte ende në emër të kësaj firme, duke deklaruar se kamionin e vozitnin edhe shoferët tjerë të kësaj kompanie, e që nga provat e administruara të lartpërmendura gjykata e ka vërtetuar se kamioni “Man” me targa të regjistrimit . . . kishte qenë pronë e të akuzuarit H. Sh. dhe këtë kamion e voziste vetëm i akuzuari H. Sh. dhe kjo vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit M. Sh. të cilët lidhur me këtë pjesë gjykata ia ka falur besimin i cili ka deklaruar se *“kamioni ka qenë i imë, pastaj ia kam dhënë H. për punë me e vozitë dhe kjo punë është më shumë se një vite e gjysmë dhe se ai kamion ka qenë në emër të firmës “. . .” prej kohës kur e kemi blerë deri me sot me datën 21.07.2020.*

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit M. Sh., gjykata dëshmisë së tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë në pjesët kur ka deklaruar se *“garazhet i ka përdorë “. . .” dhe se i kanë përdorë edhe ata si familje por jo nën stop, se garazhet janë përdorë nga kjo kompani për shkarkimin e derivateve dhe ata i përdorin këto garazhe”,* gjykata fare nuk ia ka falur besimin ngase konsideron se dëshmia e tij në këtë pjesë është thjeshtë me qëllim të mbrojtjes së vëllait të tij H. Sh. dhe se dëshmia e tij është në kundërshtim me gjithë dëshmitë e dëshmitarëve të lartpërmendur të cilëve gjykata iu ka falur besimin dhe provave të administruara të cilave gjykata iu ka falur besimin. Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit H. Z. gjykata dëshminë e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor e konsiderojë i irelevante ngase dëshmitari fillimisht kishte lidhje miqësore me të akuzuarin H. punonte me të shumë kohë më parë me të, gjithashtu edhe pse i njëjti kishte qenë së bashku me të akuzuarin ditën krikë, të njëjtit nuk i janë kujtuar shumica e ngjarjeve atë ditë dhe po ashtu gjatë dhënies së dëshmisë së tij në shqyrtim gjyqësor gjykatën e ka njoftuar se vuan nga një sëmundje e krizës së vetëdijes dhe nuk mbanë mend gjatë kohë prandaj dhe gjykata i mori si irelevante deklaramet e tij. Ndërsa sa i përket pretendimit të mbrojtjes se duke marrë në bazë të raportin e AFK-së mbi gjurmët L.nte të gishtërinjve në të cilën është konstatuar se në dëshmitë me shifrat D#1, D#2 dhe D#3, nuk është nxitur asnjë gjurmë e gishtërinjve të vijave kapilare, i akuzuari duhet të lirohet nga akuza, një pretendim ti tillë sipas vlerësimit të gjykatës është i pa bazuar ngase sipas vlerësimit të gjykatës ky raport nuk ka qenë si provë e vetme në të cilën është varur fajësia apo pafajësia e të akuzuarit ngase gjykata nga provat e lartpërmendura të cilave iu ka falur besimin e ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Andaj, mbi këto baza dhe konstatime gjykata ka vërtetuar faktin se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së.

5. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, pas administrimit të gjitha provave gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari H. Sh.i, me dashje ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6. Vendimi për shpalljen fajtor të akuzuarit

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjykata të akuzuarin H. Sh. e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, ngase në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe

analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

7. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit me rastin e matjes së dënimit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana rënduese dhe lehtësuese. Si rrethana rënduese i ka marrë për bazë këto rrethana: shkallën e përgjegjësisë penale dhe shkallën e rrezikimit të vlerës së mbrojtur duke pasur parasysh se pasojat e veprës prekin në shëndetin e njerëzve, sasinë e madhe të substancës narkotike prej 63 kilogram e 200 gram dhe llojin e substancës narkotike si dhe faktin se i akuzuari më parë kishte qenë i dënuar me aktgjykime të plotfuqishme dhe atë me aktgjykimi e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.542/07, i plotfuqishëm me datë 11.11.2008 dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 viteve për veprën penale falsifikim i parë nga neni 244 të KPRK-së, po ashtu me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-dega në Rahovec P.nr.227/17 i plotfuqishëm me datë 12.09.2018, me dënim me gjobë për veprat penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KPRK-së. Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për bazë rrethanat personale të akuzuarit: se është babai i dy (2) fëmijëve, është mbajtës i vetëm i familjes prej katër (4) anëtarësh, i njëjti kujdeset për bashkëshorten dhe dy fëmijët e tij është mbajtës si vetëm i familjes, sjella e tij gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësore ka qenë e mirë ka pasur qëndrim tejet korrekt, Prandaj, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimet e shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë reH.litimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Vendimi mbi konfiskimin

Gjykata konform nenit 267 par.5 të KPRK-së dhe nenit 282 par.1 dhe par.2 nënpar.2.4 të KPP-së, ndaj të akuzuarit ka konfiskuar substancën narkotike – marihuanë, si objekt të veprës penale dhe me pas ka urdhëruar Stacioni Policor në Gjakovë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e sasisë të konfiskuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenet 451 paragrafi 1 dhe 453 të KPP-së dhe konform nenit 39 paragrafi.3 nënparagrafi.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata ka vendosur që i akuzuari t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i Krimeve të Rënda -

PKR.nr.101/20, me datë 16.09.2020

**Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija**

**Kryetari i trupit gjykues,
Mentor Bajraktari**

KËSHILLA JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.